


# Roli dhe rëndësia e sigurimeve

## Historiku i sigurimeve

Sigurimi daton nga koha antike, në mënyra e forma të ndryshme.

Format e para të SIGURIMIT takohen në bashkësinë e hershme njerëzore brenda fisit dhe më vonë familjes. Rreziku i parë me të cilin u ballafaqua njerëzimi ishte uria dhe si masë për t'u mbrojtur ishte kontributi modest i detyrueshëm me drithëra gjatë viteve kur të korrat ishin më të frytshme.

Metodat e para të transferimit ose shpërndarjes së rrezikut në një ekonomi monetare, praktikoheshin nga tregtarët kinezë dhe babilonas, përkatësisht në shekullin e III-të dhe të II-të p.e.s. Tregtarët kinezë shpërndanin mallrat e tyre nëpër shumë anije për të kufizuar humbjen në



rast të shkatërrimit të ndonjëres anije. Babilonasit zhvilluan një sistem që u regjistrua në Kodin e famshëm të Hamurabit, 1750 p.e.s dhe praktikuar nga tregtarët e anijeve me vela të hershme të Mesdheut. Nëse një tregtar merrte hua për të financuar dërgesën e tij, ai do t'i paguante huadhënësit edhe një shumë shtesë, si garancion nga huadhënësi, që nuk do t'ia kërkonte kthimin e huas nëse do të ndodhte vjedhja apo

humbja e dërgesës në det.

*Prandaj sigurimi është metoda më e vjetër e transferimit të rrezikut, e cila është zhvilluar me qëllim që të zbutet/ulet rreziku i tregtisë.*

Kontrata e parë e sigurimit e njohur, daton në Gjenova më 1347, dhe në shekullin vijues sigurimi detar u zhvillua gjerësisht dhe primet ishin të ndryshme dhe përcaktoheshin në mënyrë intuitive. Sigurimi i pronës, ka gjurmët në Zjarrin e Madh të Londrës, i cili në vitin 1666 dogji më shumë se 13.000 shtëpi. Efektet shkatërruese të zjarrit avancuan sigurimin "nga një çështje lehtësie në një urgjencë". Më 1681, ekonomisti Nicholas Barbon dhe njëmbëdhjetë bashkëpunëtorë krijuan kompaninë e parë të sigurimit të zjarrit, "Zyrën e Sigurimeve për Shtëpi".

Fillimisht, 5.000 shtëpi u siguruan.

23 - Lloyd's Coffee House in 1798. Courtesy of Lloyd's of London.



Tregu i sigurimeve të biznesit filloi në Lloyd's Caffee House London, në pronësi të Edward Lloyd, rreth vitit 1686 dhe ishte kompania e parë për sigurim detar.

Polica e parë e sigurimit të jetës në kuptimin e vërtetë të fjalës u lëshua nga një grup i siguruesve detarë në Londër, në 1536, personit me emrin Wiliam Gybbons.

Polica ishte një vjeçare dhe vlente 400 £. Interesante është që Gybbons vdiq gjatë atij viti dhe siguruesit ia paguan shumën e siguruar familjes së tij.

## Si definohet Sigurimi sot?

Sigurimi nënkupton transferimin e një rreziku të mundshëm, të një humbjeje pasurore dhe/ose jo pasurore nga i siguruari tek siguruesi, sipas një kontrate sigurimi;



Sigurimet janë një mënyrë apo metodë që njerëzit, bizneset dhe organizatat e përdorin për të transferuar rreziqe të caktuara tek siguruesi. Koncepti i shërbimit është themelor për sigurimet. Siguruesi i shet të siguararit një premtim. Vlefshmëria e kontratës do të vërtetohet në të ardhmen.

### Çka është primi (tarifa) e sigurimit?

Përcaktimi i primeve i referohet formimit të çmimeve të sigurimit. Formimi i çmimeve të sigurimit ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga formimi i çmimeve të produktet tjera. Kur

produktet tjera të shiten, siguruesit kryesisht e dinë që më parë se sa është kostoja e produkteve, ashtu që çmimet krijohen që të mbulojnë të gjitha kostot dhe të sigurohet profiti. Mirëpo, siguruesit nuk e dinë paraprakisht se sa do të jetë kostoja. Premia e përcaktuar për sigurim mund të jetë jo adekuate për të paguar të gjitha dëmet dhe shpenzimet përgjatë vlefshmërisë së policës së sigurimit. Vetëm pas përfundimit të periudhës së mbulesës siguroese, siguruesi mund të përcaktoj humbjet e tija aktuale dhe shpenzimet. Sigurisht që siguruesi shpreson se primet e paguara në avans do të jenë të mjaftueshme për të paguar të gjitha dëmet dhe shpenzimet si dhe të sigurojnë profit.

Personi i cili përcakton tarifrat njihet si aktuar i cili angazhohet në të gjitha fazat e operacioneve të një siguruesi, duke përfshirë planifikimin, përcaktimin e çmimeve, vlerësimin e rezervave si dhe hulumtimet. Objektivë e tij është që të kalkuloi primet të cilat do të sigurojnë një biznes profitabil, që i mundëson siguruesit të konkurroj në mënyrë efektive me siguruesit e tjerë dhe që i mundëson siguruesit që të paguaj dëmet dhe shpenzimet që do të ndodhin.

### **Siguruesit përdorin konceptin e “pool-it” në shpërndarjen e rreziqeve.**



Ky koncept nënkupton që siguruesit arkëtojnë prime nga një numër i madh i policë-mbajtësve dhe nga këto prime bëjnë pagesën për humbjet ose dëmet që ndodhin brenda periudhës për një numër të caktuar të rreziqeve brenda grupit.

## Rreziqet dhe Sigurimet



### *Koncepti i Rrezikut*

Për shumë njerëz, rreziku nënkupton një lloj pasigurie për rezultatin në një gjendje të caktuar. Duke lënë për një moment anash se çfarë kuptojmë me fjalën pasiguri, zakonisht e kemi më të qartë se ç'kuptojmë kur në bisedë përfshijmë termin "risk (rrezik)". Mund të ndodhë një ngjarje, dhe nëse ndodh, rezultati

mund të mos jetë i favorshëm për ne, të mos e kemi rezultatin që shpresonim. Fjala rrezik nënkupton dyshimin për të ardhmen, ashtu edhe faktin se rezultati mund të na vejë në një pozitë më të keqe se ç'jemi në atë moment.


Tradicionalisht, rreziku definohet si pasiguri e ndodhjes se një ngjarje të caktuar e cila rezulton me humbje.

Për të analizuar nivelin e rrezikut duhen marrë në konsideratë dy faktorë: **frekuencën** dhe **ashpërsinë**.

Po ashtu dy koncepte kryesore të cilat lidhen me rrezikun kanë rëndësi të veçantë në sigurime: pasiguria dhe humbjet e papritura.



## Si bëhet vlerësimi i rreziqeve në sigurime?



Vlerësimi i rrezikut në sigurime definohet si proces gjithëpërfshirës i analizave dhe evoluimit të rrezikut.

Vlerësimi i rrezikut mund të jetë kuantitativ, gjysmë kuantitativ apo kualitativ sipas probabilitetit të ndodhjes dhe pasojave të mundshme.

Vlerësimi i rrezikut të siguruesve bazohet kryesisht në treguesit e probabilitet dhe tregues tjerë matematikor-statistikor, të cilët llogariten nga profesionist të fushës të quajtur AKTUARË.

Duke përdorur ligjin e numrave të mëdhenj, një sigurues mund të vlerësojë në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë të besueshme shumën e dëmeve për një numër të caktuar të policë-mbajtësve brenda një kohë të caktuar.

Çka është kontrata e sigurimit?



*Kontrata e sigurimit është akti, nëpërmjet të cilit siguruesi merr përsipër rreziqe të caktuara, përkundrejt pagesës së primit, që me rastin e ndodhjes së ngjarjes së siguruar t'i paguajë të siguarit, përfituesit apo palës së tretë dëmshpërblimin. Kontratat e sigurimit duhet t'i përmbushin kushtet e përcaktuara me Ligjin e BQK-së për Sigurimet dhe Ligjin për Marrëdhëniet e detyrimeve, në fuqi.*

#### ***Elementet e kontratës së sigurimit***

- **Deklarimi:** Emri i të siguarit, adresa, kompania e sigurimit, risku i siguar, shuma e sigurimit (limitet), zbritjet e mundshme, primi dhe kohëzgjatja.
- **Definicionet:** Përcaktimi i termave dhe gjuhës së përdorur në policë.
- **Marrëveshja e siguar** – Marrëveshja e kontraktuar ndërmjet kompanisë dhe të siguarit lidhur me rreziqet e mbuluara.
- **Përjashtimet** – Përcakton se çka nuk mbulohet me kontratën e sigurimit.
- **Kushtet** – përcakton kushtet, obligimet dhe rregullat që duhet respektuar.
- **Anekset** – Forma shtesë të bashkëngjitura në policën e sigurimit të cilat mundësojnë modifikimin e policës/ kontratës në kushte të ndryshme.

## ÇFARË DUHET TE DINI PARA SE TË BLENI POLICËNE SIGURIMIT?



*Polica e sigurimit është dokument me të cilin përcaktohen të drejtat dhe obligimet në mes të siguruesit dhe kontraktuesit të sigurimit.*

Njerëzit mund të sigurohen kundër pothuajse çdo rreziku të mundshëm - me një çmim.

*Si ta përzgjedh sigurimin që më nevojitet?*

Në mënyrë që të bëni zgjedhjen e duhur, duhet t'i harmonizoni nevojat tuaja të tanishme dhe të ardhshme me buxhetin të cilin e keni në dispozicion, që nënkupton zgjedhjen e llojit të sigurimit që i përshtatet nevojave dhe mundësive tuaja;

Të përcaktoni afatin e mbulimit të policës së sigurimit. Kohëzgjatja e saj varet nga vullneti dhe mundësitë tuaja;

Të siguroheni që të ardhurat tuaja janë të mjaftueshme për pagesën e primit për të cilin jeni dakorduar me siguruesin;

Të informoheni se cilat rreziqe janë të mbuluara dhe cilat janë të përjashtuara nga polica juaj e sigurimit;



Para se të nënshkruani një kontratë sigurimi, lexoni çdo pikë të kontratës me kujdes, këshillohuni me personat e autorizuar për kushtet të cilat i ofron polica e sigurimit dhe sigurohuni që e keni kuptuar qartë.

## Çka është Sigurimi jo-jetë

Sigurimi jo-jetë nënkupton sigurimin e rrezikut sipas klasave të përcaktuara me Ligjin Nr. 05 L-045 Mbi Sigurimet: Sigurimi i aksidenteve, Sigurimi i shëndetit, Sigurimi i mjeteve tokësore (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina); Sigurimi i mallrave në transport; Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës, (zjarret, shpërthimet, stuhitë, forcat e natyrës të ndryshme nga stuhia, energjia nukleare, rrëshqitja e tokës dhe tërmeti); Sigurimi i dëmtimeve të tjera të pasurisë mbulon të gjitha dëmtimet ose humbjet në pasuri, kur dëmi është shkaktuar nga breshëri, përmytjet ose nga ngrica si dhe vjedhje të ndryshme; Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i automjeteve mbulon të gjitha përgjegjësitë, që lindin nga përdorimi i automjeteve mbi tokë; Sigurimi i përgjegjësive për anijet, Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i avionëve, Sigurimi i kredive, Sigurimi i garancioneve, Sigurimi i humbjeve të ndryshme financiare, Sigurimi i mbrojtjes ligjore, Sigurimi i Asistencës.

Është e arsyeshme që njerëzit të sigurohen kundër disa prej rreziqeve më të mëdha me të cilat ballafaqohen në jetë, pasi që sigurimi mund t'i ndihmojë familjet dhe individët të përgatiten dhe të kompensojnë ndikimin e ngjarjeve të padëshirueshme në gjendjen e tyre financiare. Nëse një person është i pasiguar, ngjarjet e padëshirueshme si sëmundjet, humbja e pasurisë nga zjarri apo një aksident i madh trafiku mund të dëmtojë madje edhe të shkatërrojë situatën financiare të personit apo familjes.

Në vijim do të prezantohen karakteristikat e disa produkteve të sigurimeve jo-jetë, përfshirë sigurimin e detyrueshëm të auto përgjegjësive dhe disa lloje të sigurimeve vullnetare, respektivisht sigurimi i pronës dhe sigurimi i shëndetit.



***Sigurimi i auto përgjegjësive*** është sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësive së pronarit dhe poseduesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta dhe është i rregulluar me Ligjin nr. 04/1-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia.

Pronari i mjetit motorik para përdorimit të tij duhet të kontraktojë sigurim për mbulimin e



përgjegjësisë për dëmet e shkaktuara palëve të treta në rast vdekjeje, lëndimeve trupore, dëmtimit të shëndetit apo dëmtimit në pasuri.

*Polica e sigurimit duhet të kontraktohet vetëm nga sigurues të licencuar nga BQK. Polica e sigurimit duhet të jetë unike në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Siguruesit janë të obliguar që gjatë tërë kohës të mirëmbajnë: Aftësinë paguese dhe treguesit e likuiditetit në harmoni me Ligjet dhe Rregulloret në fuqi. Po ashtu siguruesit janë të obliguar të mbajnë fonde tjera të mjaftueshme për të shlyer çdo detyrim që rrjedh nga kontratat e sigurimit.*

I dëmtuari ka të drejtë që kërkesën për dëmshpërblim nga baza e sigurimit të autopërgjegjësisë t'ia parashtrojë drejtpërdrejt siguruesit përgjegjës.

Procedurat e trajtimit e kërkesave për kompensimin e dëmeve që rrjedhin nga sigurimi i detyrueshëm nga auto-përgjegjësia i gjeni në Rregulloren e BQK-së: [https://bqk-kos.org/repository/docs/korniza\\_ligjore/shqip/Procedurat%20e%20Trajtimit%20te%20kerkesave%20per%20kompensimin%20e%20demeve%20-%20autopergjegjesia.pdf](https://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/Procedurat%20e%20Trajtimit%20te%20kerkesave%20per%20kompensimin%20e%20demeve%20-%20autopergjegjesia.pdf), përmes së cilës përcaktohen procedurat për pranimin, regjistrimin, trajtimin, pagesën dhe kontrollimin e kërkesave për dëmshpërblim që rrjedhin nga sigurimi i detyrueshëm nga auto përgjegjësia.

Bazuar në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia, BQK ka nxjerrë rregulloren: [https://bqk-kos.org/repository/docs/korniza\\_ligjore/shqip/Implementimi%20i%20Sistemit%20BM.pdf](https://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/Implementimi%20i%20Sistemit%20BM.pdf)

për zbatimin e sistemit Bonus-Malus, që është sistem i cili zbatohet si korrektues i lartësisë së primit të sigurimit të autopërgjegjësisë, bazuar në historikun e dëmeve të siguruarit. Rëndësia e këtij sistemi është se nga Bonusi do të përfitojnë shoferët e mirë dhe të disiplinuar dhe ata që janë të kujdesshëm në trafik dhe në të njëjtën kohë nëpërmjet Malusit shoferët e papërgjegjshëm që shkaktojnë aksidente do të jenë në disavantazh.

***Sigurimi i pronës***- është sigurim vullnetar dhe bëhet me dëshirë të siguruarit. Këtu hyn pronë personale dhe kolektive, e luajtmshme dhe e paluajtmshme. Me sigurim ofrohet mbrojtja siguruuese nga rreziqet të cilat i zgjedhë i siguruari dhe të cilat shënohen në policë: zjarri, goditja e rrufesë, eksplozim, stuhia, breshri, rrëshqitja e tokës dhe shembja, vërshimi dhe rrëkeja, tërmeti, vjedhja me thyerje dhe thyerja e xhamave, etj.



### ***Pse na duhet sigurimi shëndetësor?***

Shëndeti është pasuria më e madhe në jetë, prandaj kujdesi ndaj shëndetit duhet të jetë prioriteti kryesor i individit. Sigurimi i shëndetit mbulon të ardhura fikse financiare nga paaftësia shëndetësore, përfitime me natyrë rimbursimi si dhe përftimin e kombinuar. Në bazë të policës për sigurim shëndetësor ju po ashtu do të keni mbulesë për kontrolla preventive dhe specialistike, diagnostikim, analiza laboratorike, ndërhyrje kirurgjike, mjekim spitalor në klinikat private sipas zgjedhjes tuaj.

## ***Çka është Sigurimi i jetës***

Ky sigurim mbulon sigurimin për vdekjen, sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar ose për vdekje të parakohshme, sigurimin e jetës me kthim të primeve.

Ekziston edhe *sigurimi i jetës i lidhur me ndërmarrjet e investimeve kolektive*.

*Anuiteti* nënkupton kontratë sigurimi nga e cila përfitohen të ardhura periodike, e cila mund të jetë për një numër të caktuar vitesh ose për gjithë jetën;

*Sigurimi shtesë* i cili lidhet me kontratën e sigurimit të jetës, duke përfshirë një ose më shumë nga kombinimet: vdekje si rezultat i aksidentit, paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti, paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një sëmundjeje, paaftësi e përkohshme si rezultat i një aksidenti, paaftësi e përkohshme si rezultat i një sëmundjeje, paaftësi për të kryer profesionin apo punën si rrjedhojë e dëmtimeve trupore, shërbimet spitalore, sëmundjet e pashërueshme, shërbimet mjekësore.

## **Pse do të ishte mirë të kemi sigurim të jetës?**

Meqenëse jeta është gjëja më e shtrenjtë që kemi, duhet bërë përpjekje që të marrim masa paraprake për ta mbrojtur. Një nga këto masa do të ishte edhe sigurimi i jetës, nëpërmes të së cilit do të kontribuonim në sigurinë personale, të familjes dhe do të kursenim në të njëjtën kohë.

Në jetë të gjithë planifikojmë që të arrijmë caqet tona për të krijuar një jetë më të mirë për vete dhe të afërmit. Por jo gjithçka në jetë shkon sipas planit.

Sëmundja, invaliditeti apo vdekja janë gjëra të paplanifikuara dhe të paparashikuara që mund ta godasin jetën tonë. Përveç goditjes në aspektin personal këto raste sjellin edhe problemet financiare për të gjithë familjen.



Prandaj në një mënyrë nga ne varet jo vetëm e tashmja por edhe e ardhmja e familjes dhe si masë mbrojtëse do të ishte mirë të kemi sigurimin e jetës.

*Një individ nuk duhet që qëllimin e sigurimit ta shoh si mundësi të përfitimit, por si një siguri ekonomike në rast të një ngjarje të paparashikueshme që mund ta godet shëndetin, pronën dhe jetën tonë.*

## **ÇFARË JANË PROVIZIONET TEKNIKE**

Provizionet teknike kane të bëjnë me detyrimet e marra të siguruesit sipas kontratave të sigurimit. Prandaj rezervat të cilat formohen te siguruesit duhet dalluar nga rezervat e kompanive jo financiare. Sepse rezervat te ndërmarrjet jo financiare paraqesin fitimin e pashpenzuar, derisa te siguruesit nuk mundë të trajtohen si fitim, por si burim i mjeteve të dedikuara për mbulimin e detyrimeve të ardhshme të siguruesit. Për ndarjen dhe mirëmbajtjen e provizioneve teknike, siguruesit obligohen me ligj. Sipas ligjit për sigurime qëllimi i provizioneve teknike është mbulimi i detyrimeve të ardhshme nga sigurimi dhe humbjeve eventuale nga risqet të cilat dalin nga afarizmi i sigurimit. Sepse, primi i sigurimit paguhet paraprakisht (në avans), kurse mbrojtja e siguruesit vazhdon në periudhën e ardhshme të përcaktuar me kontratë. Kështu që është me rëndësi të përcaktohen paraprakisht mjetet e nevojshme në formë të rezervës e cila do të shërbej për përmbushjen e detyrimeve të siguruesit sipas kontratave të sigurimit.

Provizionet kryesore teknike të siguruesve jo jetë janë:

- **provizionet për primin e pafitur** (angl. *Unearned premium reserves*), dhe
- **provizionet për dëme** ( angl. *Loss reserves*)

kurse siguruesit e jetës i mbajnë:

- **Provizionet matematikore** (angl. *Mathematical reserves*).

## **Roli i BQK-së:**

- të sigurojë mbrojtjen e interesave të policë-mbajtësve, të dëmtuarve, si dhe t'i mbajë të informuar në lidhje me sigurimet;
- të sigurojë ligjshmërinë, efikasitetin, stabilitetin, likuiditetin dhe aftësinë paguese të siguruesve, dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve, si dhe të subjekteve tjera të përcaktuara me këtë ligj;
- të sigurojë një konkurrencë të drejtë dhe të rregullt, duke inkurajuar në këtë mënyrë zhvillimin, shtrirjen e produkteve dhe shërbimeve të sigurimit në dobi të mirëqenies publike, si dhe krijimin e një ambienti të përshtatshëm për investitorët potencialë në industrinë e sigurimeve në Kosovë.

Mbështetur në faktin se mbikëqyrja e sigurimeve përbëhet nga aktivitete të ndryshme, sidoqoftë objektivë primare është mbrojtja e interesave të policë-mbajtësve.

Me një kornizë rregullative të qëndrueshme, BQK, respektivisht mbikëqyrja e sigurimeve në vazhdimësi është koncentruar në mbikëqyrjen e vazhdueshme si një ndër shtyllat kyçe të procesit të mbikëqyrjes, ku këtë proces e realizon përmes instrumenteve mbikëqyrëse përkatësisht divizionit për raportim dhe analiza dhe divizionit të mbikëqyrjes në vend. Bazuar në qasjen pro-aktive të DMS-së si dhe përmes instrumenteve mbikëqyrëse është arritë që të identifikohen me kohë problemet potenciale si dhe sipas nevojës janë ndërmarrë masa preventive/korrigjuese para se problemet e sektorit të sigurimeve të bëhen serioze.

Duhet theksuar se mbikëqyrja e siguruesve gjithnjë e më tepër po koncentrohet drejt qasjes së bazuar në rrezik, përmes së cilës qasje po bëhet fokusimi tek ata sigurues me profil më të lartë të rrezikut. Në këtë drejtim është përgatitur manuali i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik implementimi i të cilit do të bëhet në të ardhmen e afërt, ku përveç se përmes të njëjtit do të caktohet strategjia mbikëqyrëse për siguruesit, gjithashtu do të rritet në vazhdimësi cilësia dhe zbatimi i procedurave të mbikëqyrjes.